



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.632/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Adnan Konushevci anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizjës Vetëvendosje (LVV), të paraqitura kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2021, mori këtë:

#### VENDIM

**I. PRANOHEN** të bazuar ankesat A.nr.632/2021 dhe A.nr.633/2021 të datës 17.10.2021, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa subjektit poltik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 600.00 (gjashtëqind) euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – Thyrrja e heshtjes zgjedhore përmes rrejeteve sociale.

**II. DETYROHET** subjekti politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin,, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

#### Arsyimet

Me datë 17.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.632/2021 dhe Anr.633/2021, të datës 17.10.2021, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitura kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, në të cilat pretendohet se kandidati për kuvend komunal të Obiliqit Abdyrrahman Krasniqi, dhe Alba Mirena përkrahëse e këtij subjekti kanë thyer heshtjen zgjedhore duke bërë postime në llogaritë e tyre në Facebook, me përbajtje elektorale, duke bërë thirrje për votimin e kësaj Iniciative Qytetare.

Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Paneli, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, lidhur me ankesat e paraqitura nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.

Në përgjigje në ankesë të datës 18.10.2021, subjekti politik Iniciativa Qytetare për Obliqin, i ka kundërshtuar pretendimet e ankuesit duke theksuar se nuk ka pasur shkelje apo tentim për të thyer heshtjen zgjedhore. Më tej në përgjigje në ankesë shtojnë se edhe vet antarët subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë bërë postime të tillë në ditën e heshtjes zgjedhore. Ku për këtë ka ofruar edhe një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe provave materiale të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesat janë të bazuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.632/2021 dhe Anr.633/2021, kanë përbajtje dhe natyrë të njëjtë të shkeljes së pretenduar, paraqitës i të dy ankesave është subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, Iniciativa Qytetare për Obliqin, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: “*Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkin e ankesave që përbajnjë në vete çështje të ngashme dhe se ato ankesat tē trajtohen me një vendim*”, bëri bashkin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se kandidati për kuvend komunal Abdyrrahman Krasniqi nga radhët e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obliqin dhe Arba Mirena përkrahëse e po të njëjit subjekt politik, gjatë ditës së votimit në rrjetet e tyre sociale Facebook, kanë bërë fushatë zgjedhore duke udhëzuar që të votohet subjekti politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin dhe kandidatët e saj, të apostrofuar në ankesë ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesave, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, përfaktin se në llogaritë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e votimit postimet janë aktive, të cilat promovojnë subjektin politik Iniciativa Qytetare për Obliqin, kandidatin për kryetar të Komunës së Obiliqit dhe kandidatët për kuvend komunal të Obiliqit, nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obliqin, se pretendimet e palës ankuese lidhur me shkeljet apo tentimin përfshirë heshtjen zgjedhore dhe pohimi i tyre se në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe antarët e subjektit politik LVV, duke bërë postime në ditën e heshtjes zgjedhore, Paneli i vlerësoi si jo relevante për vendosje në këtë çështje.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që

nga prova e ofruar nga ana e tyre dhe nuk mund të argumentohet se edhe subjekti politik LVV, ka bërë një shkelje e tillë.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, mos pjesëmarrjen e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obliqin, në zgjedhjet e mëparshme në Republikën e Kosovës, që konsiston në faktin se kandidati për kryetar të kuvendit komunal të Obiliqit, nga radhët e këtij subjekti, Abdyrrahman Krasniqi, dhe përkrahësja Alba Mirena, nuk ka qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të heshtjes zgjedhore, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje në Kosovë që do të thotë se i njëjtë nuk ishte i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe i njëjti subjekt politik nuk ka marrë asnje shumë të fondevë nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Obliqin, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, të njëjtat ishin jo relevante dhe jo me ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosë dhe se nuk kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënim i paguan të njëtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “*120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.632/2021 me datën 18.10.2021**

**Kryesuese e Panelit**

Kymete Kicaj

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetkatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.